

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK 2018 PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJE PËR NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM TË SHQIPËRISË NË BE NË SEKTORIN EKONOMIK”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”” propozohet në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë.

Kjo marrëveshje është propozuar nga pala gjermane, nisur nga dëshira për t'i forcuar e thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit teknik, si partnerë, të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë në protokollin e bisedimeve qeveritare të datës 22.10.2018.

Objektivi kryesor i zbatimit të këtij projekti është forcimi i kompetencave për zhvillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE, me fokus në disa kapituj të caktuar të legjislacionit të BE-së, që i përkasin sektorit ekonomik. Për arritjen e këtij objekti dhe brenda këtij fokusi, pritet që projekti të japë rezultate në tri fusha komplementare veprimi:

1. Zhvillimi i kapaciteteve dhe i metodologjive: në këtë fushë projekti pritet të japë mbështetje për pajisjen e anëtarëve të grupeve ndërinstitucionale të punës për disa kapituj të caktuar me instrumente pune, si edhe njohuri e aftësi të nevojshme për zhvillimin e negociatave.
2. Parapërgatitje për të adresuar kushtet potenciale për hapjen/mbylljen e negociatave në kapitujt e caktuar (*opening/closing benchmarks*): në këtë fushë pritet të jepet mbështetje për përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe

të planeve të veprimit, të shoqëruara me masa për zhvillimin e kapaciteteve personale në hartimin e tyre.

3. Përfshirja e shoqërisë civile: në këtë fushë pritet të jepet mbështetje për identifikimin e aktorëve relevantë të shoqërisë civile, sipas fushave të caktuara dhe përfshirja efektive e tyre në përgatitjet për bisedimet e anëtarësimit.

Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik” shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej 2 000 000,00 (dy milionë) eurosh. Projekti do të ketë një kohëzgjatje prej 3 vjetësh.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me protokollin e bisedimeve qeveritare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin ekonomik për zhvillim, të zhvilluar më 22.11.2018. Projektligji i hartuar nuk është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në zbatim të dispozitave të marrëveshjes bazë për bashkëpunimin teknik, nënshkruar më 21.10.1988, duke njohur prioritetet e qeverisë shqiptare në sektorin ekonomik, qeveria gjermane ka rënë dakord për të financuar projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”. Mbështetja dhe zbatimi i këtij projekti është me shumë interes për vendin tonë në kuadrin e zhvillimit të negociatave për anëtarësim. Ky bashkëpunim do të ofrojë një kontribut të rëndësishëm në kuadër të procesit të *screening* dhe përgatitjes për zhvillimin e bisedimeve për anëtarësim në disa kapituj të caktuar që janë tejet të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Kjo marrëveshje paraqet interes në aspektin e zhvillimit social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

Detajet e projektit, si dhe ato për detyrimet e shërbimet, që duhet të kryhen reciprokisht, do të përcaktohen në një kontratë të veçantë zbatimi që do të nënshkruhet ndërmjet *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*, në cilësinë e agjencisë zbatuese të këtij projekti, dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e institucionit përfitues të asistencës teknike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën, me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”.

Kjo marrëveshje përbëhet nga 5 nene.

Neni 1 përcakton se kjo marrëveshje është lidhur në zbatim të marrëveshjes së datës 21.10.1988, për bashkëpunimin teknik ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe mbështetet projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”. Në nenin 1, të draftmarrëveshjes, është përcaktuar se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik” shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej 2 000 000,00 (dy milionë) eurosh.

Për zbatimin e këtij projekti pala gjermane ka ngarkuar Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ GmbH*).

Në këtë nen përcaktohet gjithashtu se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë kështu zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset që institucionet e ngarkuara prej tij me zbatimin e projektit të kryejnë shërbimet e nevojshme për projektin.

Në paragrafin e fundit të këtij neni është përcaktuar gjithashtu se angazhimet e marra në kuadër të këtij projekti dhe, referuar shumës prej 2.000.000 eurosh, do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit dhe eventualisht të financimit, përmendur në nenin 2. Për këto shuma afati përfundon me mbarimin e datës 31 dhjetor 2022. Nëse kontratat e zbatimit, dhe eventualisht të financimit, lidhen brenda afatit të parashikuar vetëm për një pjesë të premtimit financiar, atëherë kjo klauzolë zhvlerësimi vlen vetëm për atë pjesë të fondeve, që nuk është ende objekt i këtyre kontratave.

Neni 2 i marrëveshjes përcakton se detajet e projektit “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”, po ashtu detyrimet dhe shërbimet, që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve.

Neni 3 parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

- për të përjashtuar materialet, automjetet, mallrat e pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit nga detyrimet tarifore të importit dhe të eksportit, detyrimet tarifore për licencat, taksat e portit e të magazinimit dhe nga taksa të tjera publike, sikurse garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonesë;
- për të përjashtuar organizatën zbatuese të projektit nga të gjitha taksat dhe tatimet direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe zbatimi i kontratave të zbatimit dhe, eventualisht, financimit;
- për të rimbursuar, me kërkesën e organizatës zbatuese gjermane, vlerën e TVSH-së apo të taksave të ngjashme indirekte, që janë mbajtur në Republikën e Shqipërisë për objektet e siguruara dhe shërbimet e kryera në kuadër të lidhjes dhe të zbatimit të kontratave të zbatimit dhe, eventualisht, financimit. Taksat për konsumin, të mbajtura në këtë kontekst, merren

përsipër prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë pas bërjes së kërkesës përkatëse.

Në nenin 4 është parashikuar se për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së përmendur në nenin 1, të paragrafit 1, të datës 21 tetor 1988, lidhur ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për bashkëpunimin teknik.

Në nenin 5 janë parashikuar rregullat për hyrjen në fuqi të marrëveshjes, ndryshimin, shfuqizimin dhe interpretimin e saj.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe çdo institucion përfitues i fondeve për projekte të financuara prej tyre.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE PERSONAT DHE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Marrëveshja është propozuar nga Ambasada e Republikës Federale Gjermane. Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka ndjekur procedurat e parashikuara në ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për konsultimin, miratimin në parim dhe nënshkrimin e marrëveshjes mes palëve.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë do të përfitojë grant në shumën prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh.

Nga ana tjetër, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së (rreth 65 000 euro) nëpërmjet institucionit përfitues, në përputhje me nenin 3, të marrëveshjes, si dhe me vendimin nr.509, datë 12.08.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përballimit të TVSH-së, që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë”.

KËSHILLI I MINISTRAVE